



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Albi Company" Sh.P.K. të datës 18.06.2023 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "78 Renovimi dhe mirëmbajtja e IEAA - gëlqerosja" me nr. të prokurimit 616-24-5609-5-2-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Albi Company" Sh.P.K. të datës 18.06.2023 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "78 Renovimi dhe mirëmbajtja e IEAA - gëlqerosja" me nr. të prokurimit 616-24-5609-5-2-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëjë korigjimin e kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHEN** të gjitha palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Albi Company" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 18.06.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "78 Renovimi dhe mirëmbajtja e IEAA - gëlqerosja" me nr. të prokurimit 616-24-5609-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin merititor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

- P.1. - "kerkojme nga ana e juaj si AK-se që të largohet pozicioni 12.2 nga paramasa".
- P.2. - "Pozicioni 6.7 duhet të përmirësohet të bëhet 3500 m. Të masa rrafshuese duhet të shtohet përshkrimi edhe demolimi (shtohet teksti) -Duhet të shtohet edhe një pozicion të demolimi I mases së gëdit për plafone 3500 m. - Sipas paramases ngjyrosje të mureve kemi 16630 m"
- P.3. - "ne si OE ankues, por nga ana juaj si AK që të eliminohet kërkesa e pikës D ku kërkohej Një Inxhinier i Diplomuar Ndertimtarisë Drejtimit Hidroteknik".
- P.4. - "kerkojme nga ana e juaj si AK që të eliminohet kërkesa e pikës E ku kërkohej Një Inxhinier i diplomuar i Makinerisë".
- P.5. - "kerkojme nga ana juaj si AK që të eliminohet kërkesa e pikës E ku kërkohej Një Gjeoder ose Bachelore i Gjeodezisë me Licence nga AKK".
- P.6. - "Ne pikën G tek kërkesa 2 është kërkuar Një Inxhinier ose Bachelore për Menaxhimin e emergjencave i trajnuar për siguri dhe shëndet në punë Pyetje për pikën G – A lejohet që të posedojë Diplome Master për menaxhimin e Emergjencave dhe A lejohet që për të njëjtin të dorëzojë Certifikatën ku i njëjti ka dhënë provimit profesional nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë pranë MPMS".
- P.7. - "kerkojme që të eliminohet kërkesa Një parketshtrues".
- P.8. - "kerkojme që të eliminohet kërkesa Një person i certifikuar për rrezikun nga lartësia dhe përdorimi i PMI për mbrotje nga lartësia".
- P.9. - "Se paku një kamion me kran me peshe bartese 1 deri 2 ton Se paku një kamion me kran me peshe bartese mbi 10 ton Konsiderojme se këto dy kamion me kran duke u specifikuar pesha bartese janë të pa arsyeshme pasi që me punët që janë parashikuar të ekzekutohen janë punë renovuese ku këto paisje aspak nuk janë të nevojshme gjatë ekzekutimit. Ne si OE duke analizuar paramasën dhe paralogarinë konsiderojme se me se e mjaftueshme është një kamion me kran me peshe mbartese deri 10 tone. Andaj kerkojme që për paisjet 1 dhe 2 të jete vetëm një kamion me kran që ka peshe bartese deri 10 ton".
- P.10. - "kerkojme që të eliminohet kërkesa nr 4 thithese elektrike".
- P.11. - "Së paku një ashensor për bartjen e materialit Kjo kërkesë është e pa dobishme gjatë ekzekutimit të punëve neper objekte shkollore, ku në gjithë shkollat nuk ekziston ndonjë hapësirë që vendoset ky ashensor për bartje të materialeve, Ku dihet se shumica e shkollave ekzistuese janë me lartësi ndertimi përderis dhe një kat Andaj nuk është lartësi e kateve në shkollat që të bëhet mbartja e materialeve pa tjetër me ashensor, Ndoshta renovimet e parashikuar në objekte janë në katin përderis që nuk është e nevojshme as ashensori. Është kriter që pretendojmë se ju është përgatite për ndonjë operat ekonomik të veçant".

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, fillimisht duhet cekur se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësi kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe paralogarinë. Tutje përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, paralogaritë dhe vizatimet.

Sa i përket pretendimit me nr. 8 dhe 9, në koordinim me njësinë kërkuese është gjetur se këto pretendime janë të bazuara për arsye se kërkesat që ju referohen këto pretendime

nuk janë kërkesa absolutisht të domosdoshme. Prandaj AK do të publikoj formularin për korigjimin e gabimeve përmes të cilit do të ndryshoj apo do të largoj në tërësi këto kërkesa të dosjes së tenderit.

Sa i përket pretendimeve të tjera ankimore (1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 10 dhe 11), të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit janë përcaktuar në koordinim të plotë me njësinë kërkuese. Si të tilla këto kërkesa të dosjes së tenderit mbeten të pandryshuara sepse jo vetëm që janë në përputhje të plotë me qëllimin e projektit dhe nevojat e njësisë kërkuese, por janë edhe të domosdoshme që të realizohet me sukses, pra në mënyrë efikase dhe efektive kontrata që synohet të lidhet përmes këtij aktiviteti të prokurimit. Në anën tjetër parashtruesi nuk ka prezantuar asnjë argument pse këto kërkesa të dosjes së tenderit nuk janë të lejuara sipas LPP në fuqi duke mbështetur argumentet në prova apo dëshmi konkrete. Vlen të thuhet se parashtruesi në rast se ka paqartësi apo pyetje lidhur me mënyrën e formulimit të kërkesave të caktuara në dosjen e tenderit, atëherë mund të parashtroj kërkesë të re për sqarime shtesë duke përdorur formularin e KRPP - B47 Letër standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit ose të referohet të sqarimet që tanimë mund të jenë bërë nga AK. Formulari i kërkesës për rishqyrtim (F02) nuk është i destinuar për veprime juridike përtej atyre që janë përcaktuar sipas nenit 59, 60 et. al. të RRPP. Përndryshe çdo operator ekonomik e mbanë përgjegjësinë e plotë për gabimet eventuale me rastin e ofertimit në një aktivitet të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur vetëm pretendimet e tij ankimore me nr. 8 dhe 9 por jo edhe pretendimet tjera ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar vetëm pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 24.06.2024

Visar SHEHU
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Faqe 3 nga 3

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net